

Takimi i Komitetit të Kontaktit dhe i Rrjetit të Koordinatorëve të Vendeve Kandidate dhe Kandidate të Mundshme për në BE

Lisbonë më 20-22 qershor 2023

Në datat 21-22 qershor 2023 u zhvillua në Lisbonë takimi vjetor i Komitetit të Kontaktit me pjesëmarrjen e Presidentëve të SAI-ve të vendeve anëtare të BE-së, ECA-s (Gjykata Europiane e Llogarive) si dhe përfaqësues të lartë të Komisionit Europian.

Axhenda e Komitetit të Kontaktit përgjatë dy ditëve patën në vëmendjen kryesore çështjen e Energjisë, se si SAI-t mund të kontribuojnë për një zbatim më të mirë dhe përmbushjen e SDG 2030, si dhe rimëkëmbjen e këtij sektori. Përfaqësuesit e SAI-ve sollën eksperiencat e tyre në këtë fushë duke u ndalur më së shumti në vështirësinë e zbatimit të masave të marra.



U trajtuan gjerësisht nga përfaqësuesit e SAI-ve edhe auditimet e kryera në vijim të krizës energjitike, të trajtuara si mjet lehtësues për rimëkëmbjen dhe stabilizimin (RRF), veçanërisht me fokus në ndryshimet dhe evolucionin e fondeve të BE-së dhënë për këtë sektor, vlerësimi i rezultateve dhe impakti në secilin vend i këtyre auditimeve, si dhe sistemet e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së.

Një nga çështjet e trajtuara dhe që ka një sensibilitet të veçantë në komunitetin e SAI-ve është ajo e pavarësisë institucionale. Me këtë rast, SAI i Polonisë solli eksperiencën në trajtimin e rastit të kërcënimeve ndaj pavarësisë drejtuar këtij institucioni dhe mbështetjen e dhënë nga IDI nëpërmjet mekanizimit për mbrojtjen e pavarësisë së SAI-ve, SIRAM.

Komiteti i Kontaktit në mbështetje të plotë ndaj SAI-t të Polonisë do të hartojë një rezolutë të posaçme, e cila do të shërbejë si një mjet solidarizimi dhe sensibilizimi për të frenuar sa më parë risqet dhe kërcënimet ndaj pavarësisë së këtij institucioni.

Takimi i radhës i Komitetit të Kontaktit do të zhvillohet në tetor 2024 në Qipro.



Në prag të takimit të Komitetit të Kontaktit u zhvillua më 20 qershor takimi i Koordinatorëve të Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe kandidate të mundshme për në BE. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe bashkëpunëtorët e përhershëm të këtij Rrjeti, përfaqësuesit e Gjykatës Europiane të Llogarive, SIGMA-s dhe Grupit të Punës së Përbashkët për Aktivitetet Audituese të Komitetit të Kontaktit (JWGAA).

Takimi u drejtua nga përfaqësuesit e Institucionit Suprem të Auditimit të Bosnje dhe Hercegovinës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Institucioneve Supreme të Auditimit të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Turqisë, Moldavisë, Ukrainës dhe Serbisë. Fokusi ishte rishikimi i Kuadrit të Bashkëpunimit të Rrjetit si dhe Plani i punës 2022- 2025, veçanërisht zbatimi i aktiviteteve të miratuara për të ardhmen.

Përfaqësuesit e SAI-ve respektive raportuan mbi aktivitetet e realizuara si webinar i Menaxhimit të Cilësisë, mbajtur më 13 prill 2023, tryeza e rrumbullakët për angazhimin e palëve të interesit, mbajtur në Sarajevë më 5 dhe 6 qershor 2023, si dhe ecuria e programit të trajnimit për auditimet e performancës në nivel rajonal i hartuar për audituesit e rinj.

Në kuadër të planifikimit të aktiviteteve për t'u zhvilluar në vijim, nga SAI i Kosovës u propozua që aktiviteti mbi Auditimet e Përputhshmërisë të zhvillohet në muajin tetor në Prishtinë në kuadër të përvjetorit të 20 të këtij institucioni. Ndërsa aktiviteti i menduar të zhvillohet si webinar mbi Auditimin e Buxhetit të Shtetit, do të zhvillohet me prezencë fizike në Malin e Zi gjatë vitit 2024.

Koordinatorët diskutuan gjithashtu edhe mbi vijueshmërinë e organizimit të takimeve të titullarëve të institucioneve të Rrjetit dhe koordinimin lidhur me informimin dhe komunikimin në kohë të aktiviteteve që zhvillohen në secilin SAI, me qëllim shkëmbimin e informacioneve dhe njohurive.

KLSH u përfaqësua në këto takime nga znj. Valbona Gaxha, Sekretar i Përgjithshëm dhe znj. Dëshira Huqi, Përgjegjëse Sektori dhe koordinatore për KLSH-në.